



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**, nenit 14, paragrafi 14.1 dhe nenit 40, paragrafi 40.2, shkronja **a**, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dhe të nenit 34 paragrafi 1, shkronja **c**, e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.12.2016, miratoi këtë

V E N D I M

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR VENDOSJEN,
NDËRTIMIN DHE LARGIMIN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË PRONËN
PUBLIKE**

I.

MIRATOHET Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike, 01. nr. 110-157481, dt. 01.07.2014.

II.

Neni 4, paragrafi 1, shkronja **b**, ndryshon si në vijim:

b) qoshqet, dyqan i vogël, i vendosur në bazën e betonit, i punuar nga materiali i lehtë, me sipërfaqe e cila nuk mund të jetë më e madhe se 18 m² dhe lartësi deri në 2.20 m, ku shiten gazeta ose çikërrima të ndryshme.

III.

Neni 12, paragrafi 2, fshihet në tërësi, ndërsa paragrafi 3, rinumërohet dhe bëhet paragrafi 2.

IV.

Neni 13, ndryshon si në vijim:

Komuna shqyrton dhe, sipas nevojës, ndryshon Planin për vendosjen e objekteve të përkohshme çdo pesë (5) vjet.

V.

Neni 16, ndryshon si në vijim:

Inspeksioni ndërtimor kryen inspektimin e punëve ndërtimore për të gjitha fazat, për të verifikuar pajtueshmërinë me dokumentet ndërtimore, dhe verifikon përputhjen e punëve të përfunduara me dokumentacionin ndërtimor, për të cilat harton protokoll mbi përfundimin e fazës respektive të ndërtimit, i cili nënshkruhet nga poseduesi i lejes, kontraktuesi dhe inspektori.

VI.

Neni 17, paragrafi 1, ndryshon si në vijim:

Nëse kushtet e parapara sipas Ligjit për ndërtim dhe kësaj rregulloreje janë përmbushur, organi i administratës i cili e ka dhënë lejen për ndërtim, ka për detyrë të japë certifikatën e përdorimit brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës.

Neni 17, paragrafi 2, ndryshon si në vijim:

Organi kompetent mund të refuzojë dhënien e certifikatës për përdorim, nëse investuesi nuk i ka plotësuar kushtet në lejen për vendosje/ndërtim dhe nuk ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm/protokollet.

VII.

Neni 18, ndryshon si në vijim:

Nëse gjatë inspektimit vërtetohet se lëshimet në objektin e vendosur/ndërtuar nuk mund të mënjahen, dhe për shkak të atyre lëshimeve ekziston rreziku i drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e njerëzve, Inspeksioni ndërtimor merr vendimin për rrënimin e objektit, përkatësisht largimin e objektit.

VIII.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

nr. nr. 355-311296, më 22.12.2016

KRYESUESI I KUVENDIT

Halim Halimi, jur. i dpl.